

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Aksion në Tiranë, arrestohen 8 persona të kërkuar për krime të rënda, dro*ë dhe vjedhje - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/aksion-ne-tirane-arrestohen-8-persona-te-kerkuar-per-krime-te-renda-dro-e-dhe-vjedhje/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 15:24:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 14:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	85b9642572c9895bbcf84b8f2d426f0fb7f0bc3c297466825c0abd651eecfc0a
TEKSTI	dfe8fd31e2d7b0a149fccec0250ed7fc956924e97d32bf7764fc2bd6c040c1b98
PAMJA	0ae6664da50d85bff5be55776f0ff232f0c162f87b0af6adf11f45a9626d7b1f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fae7071e80c0cf68ff5a603ed193932e364a655459c6821d177fcee494393d69
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c206ef00f3c5688ec3d6505e364edf4e33bce2ceb75a58f689bcce7e176545ba
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fae7071e80c0cf68ff5a603ed193932e364a655459c6821d177fcee494393d69>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Aksion në Tiranë, arrestohen 8 persona të kërkuar për krime të rënda, dro*ë dhe vjedhje

AKTUALITET

Demo

Aksion në Tiranë, arrestohen 8 persona të kërkuar për krime të rënda, dro*ë dhe vjedhje

SEPTEMBER 24, 2026



Policia e Tiranës ka zhvilluar një operacion të posaçëm për lokalizimin dhe kapjen e personave të shpallur në kërkim. Në kuadër të kontrolleve dhe veprimeve operative, janë arrestuar 8 persona, të kërkuar për vepra të ndryshme penale, nga krimet e rënda dhe armëmbajtja pa leje, te narkotikët, vjedhja dhe falsifikimi i dokumenteve.

Sipas Policisë, një prej personave të kërkuar për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve është kapur me një sasi të dyshuar Cannabis Sativa, e cila është sekuestruar si provë materiale.

Në pranga kanë përfunduar:

- **K. T., 39 vjeç**, ndaj të cilit ishte caktuar masa e sigurisë “Arrest në burg”, i dyshuar për “Vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, si dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”.
- **E. B., 31 vjeç**, i dënua me 2 vite burgim për veprën penale “Plagosja e rëndë me dashje”.
- **N. M.**, i dënua me 4 muaj burgim për “Falsifikimin e dokumenteve”.
- **S. V., 18 vjeç**, i shpallur në kërkim nga DVP Elbasan për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.
- **K. Xh.**, i dënua me 3 muaj burgim për veprën penale “Vjedhja”.
- **R. L., 26 vjeç**, i dënua me 3 muaj burgim për “Prishjen e qetësisë publike”. Sipas Policisë, atij i kanë mbetur për të vuajtur edhe 1 muaj e 3 ditë burgim.
- **O. N., 30 vjeç**, ndaj të cilit ishte caktuar masa e sigurisë “Arrest në burg” për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.
- **K. M., 29 vjeç**, i shpallur në kërkim për “Prodhimin dhe shitjen e narkotikëve”. Gjatë ndalimit, policia i gjeti një sasi të dyshuar Cannabis Sativa, e cila u sekuestrua.

Operacioni u zhvillua nga strukturat e ndryshme të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në bashkëpunim me komisaritet e kryeqytetit dhe Forcën e Posaçme Operacionale.

Pas arrestimeve, materialet procedurale janë referuar në Prokurori për veprime të mëtejshme.

arrestime droge policia Tiranë

SHARE.

Postimet e reja

Aksion në Tiranë,
arrestohen 8 persona të...

SEPTEMBER 24, 2026

Carney: Ndërhyrja
amerikane në Kanada nu...

SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni
Meqemeja i dha Ahmetaj...

SEPTEMBER 24, 2026

Açuge nga Shqipëria me
nivele të larta histamine...

SEPTEMBER 24, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç ‘Delvina Gas’ ai...

ALERT në Slloveni për VIPA
Flips të Kosovës, kanë
përmbytje të alergjenësh.
Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata
në kërkim të “Top Fruits”
të Ejup Ahmetit dhe Marin
Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë
pas hapjes së thirrjes për
grantet e startupeve fitoi
6.1 milionë lekë në fazën e
rezervuar për biznese të
paktën 1-vjeçare

Na ndiq

[Facebook](#)[Instagram](#)[YouTube](#)[TikTok](#)

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

[raporto këtu](#)

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.